



**Drejtoria ekonomike e
Universitetit “A Xhuvani”,
Elbasan**

Njofton

studentë

Mbështetur në VKM Nr. 998, datë
30.09.2009 "Për kuotat financiare te
ushqimit ne mensat e konvikteve, bursat e
shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe te
studentëve, në Institucionet Arsimore
publike, për vitin shkollor 2009 - 2010"

për bursat

- A. Studentët e viteve të para të gjitha Degëve të Universitetit të interesohen për bursë pranë BASHKIVE dhe KOMUNAVE ku kanë vendbanimin e tyre. Pranë Universitetit të marrin vetëm vërtetimin që janë studentë në këtë Universitet (*Pranë sekretarive të çdo dege*). Vendimet e pushteteve vendore të jenë me vulë të njomë dhe të konfirmuara nga Drejtoritë Arsimore Rajonale/Zyrat Arsimore të Rretheve përkatëse.

B. Studentët e viteve II, III, të degës matematikë fizikë që vitin paraardhës e kanë notën mesatare mbi 8 dhe studentët që vitin paraardhës e kanë notën mesatare 10, të sjellin vetëm vërtetimin që janë studentë.

C. Studentët e viteve II, III, të gjitha degëve dhe studentët e vitit të IV të Fakultetit ekonomik, që kanë qenë trajtuar me bursë një vit më parë, si dhe ata që kërkojnë të përfitojnë nga bursat e ndërmjetme në dispozicion të Universitetit, të sjellin brenda datës **15.11.2009** këto dokumente:

Për studentët me banim në Fshat (Komuna)

1. Certifikatën e trungut familjarë. (*Zyrat e Gjendjes Civile ku banon me vulë të njomë, lëshuar pas muajit tetor 2009*)
2. Vërtetimin në emër të kryefamiljarit për trajtimin e familjes së tij me ndihmë ekonomike ku të specifikohet masa e ndihmës në vlerë (lekë) e shprehur me fjalë. Vërtetimi të ketë nr_ dosje dhe numrin e frymëve që përfitojnë ndihmë. (*Zyrat e ndihmës pranë vendbanimit , firmosur e vulosur nga Kryetari i Komunës*).

Për studentët me banim në Fshat (Komuna)

3. Vërtetim nga Zyra e Kadastrës për sipërfaqen e tokës që ka ose jo në pronësi/përdorim familja. *(Zyrat e kadastrës janë pranë çdo Qarku dhe kanë vulën e Qarkut, jo në Bashki)*
4. Vërtetimi për sasinë e të ardhurave (lekë) që përfiton familja nga toka. *(Në Komunën ku banon).*

Për studentët me banim në Fshat (Komuna)

5. Vërtetimin për anëtarët e familjes që janë nxënës ose studentë, për trajtimin ose jo me bursë nga institucionet ku studiojnë.
(Universitetet dhe shkollat e mesme përkatëse)
6. Vërtetimin që janë studentë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan *(Sekretaritë mësimore të degës përkatëse)*

Për studentët me banim në Qytet (Bashki)

1. Certifikatën e trungut familjarë .(*Zyrat e Gjendjes Civile ku banon me vulë të njomë , lëshuar pas muajit tetor 2009*).
2. Vërtetimin në emër të kryefamiljarit për trajtimin e familjes së tij me ndihmë ekonomike ku të specifikohet masa e ndihmës në vlerë (lekë) e shprehur me fjalë. Vërtetimi të ketë nr_ dosje dhe numrin e frymëve që përfitojnë ndihmë. (*Zyrat e ndihmës pranë vendbanimit , firmosur e vulosur nga Kryetari i Bashkisë*)

Për studentët me banim në Qytet (Bashki)

3. Vërtetimin për anëtarët e familjes që janë nxënës ose studentë, për trajtimin ose jo me bursë nga institucionet ku studiojnë.
(Universitetet dhe shkollat e mesme përkatëse)
4. Vërtetimin që janë studentë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan *(Sekretaritë e degës përkatëse)*

Për studentët me banim në Qytet **(Bashki)**

Në qoftë se familja (trungu familjarë) nuk merr ndihmë ekonomike, të sillen edhe këto dokumente:

Për studentët me banim në Qytet (Bashki)

5. Vërtetim nga zyra e punës për pjesëtarët në moshë pune. *(Zyrat e punës në çdo Qark)*
6. Vërtetim nga dega tatim taksa për pjesëtarët që kanë ose jo aktivitet privat *(Dega Tatim Taksa)*
7. Vërtetim nga Zyra e Inspektoratit rrugor që prestarët e familjes kanë ose jo automjet. *(Dega Rajonale e Inspektoratit Rrugor)*

Për studentët me banim në Qytet (Bashki)

8. Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore, që përfitojnë ose jo familja të ardhura nga Buxheti i Shtetit.
(Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore)
9. Vërtetim nga Zyra e Kadastrës për sipërfaqen e tokës që ka ose jo në pronësi/përdorim familja.
(Zyrat e kadastrës janë pranë çdo Qarku dhe kanë vulën e Qarkut, jo në Bashki).
10. Vërtetimi për sasinë e të ardhurave (lekë) që përfiton familja nga toka. *(Në Bashkinë ku banon).*

Për specifika të veçanta,
përveç dokumenteve të
mësipërme për kriterin
ekonomik të sillen edhe
këto dokumente:

Për specifika të veçanta, përveç dokumenteve të
mësipërme për kriterin ekonomik të sillen edhe këto
dokumente:

- Studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit të sjellin dokumentin e statusit të jetimit (fotokopje e noterizuar),

Për specifika të veçanta, përveç dokumenteve të mësipërme për kriterin ekonomik të sillen edhe këto dokumente:

- Studentët, që kanë humbur kujdestarinë prindërore, me vendim gjykate të formës së prerë, të sjellin vendim gjykate të formës së prerë (fotokopje e noterizuar),

Për specifika të veçanta, përveç dokumenteve të
mësipërme për kriterin ekonomik të sillen edhe këto
dokumente:

- Secili nga studentët bashkëshort, me fëmijë, të sjellë certifikatë familjare dhe vërtetimin që banon në konvikt publik,

Për specifika të veçanta, përveç dokumenteve të mësipërme për kriterin ekonomik të sillen edhe këto dokumente:

- Fëmija, student, i punonjësit të Policisë së Shtetit apo i Forcave të Armatosura, që ka humbur jetën në krye a për shkak të detyrës, të sjellë statusin (fotokopje e noterizuar),

Për specifika të veçanta, përveç dokumenteve të
mësipërme për kriterin ekonomik të sillen edhe këto
dokumente:

- Studenti, që ka statusin e invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, të sjellë dokumentin përkatës (fotokopje e noterizuar)

Nuk përfitojnë bursë studentët;

- që janë me banim në fshat dhe që familja nuk trajtohet me ndihmë ekonomike,
- që figurojnë në Gjendje Civile të ndarë nga trunngu familjarë,

Nuk përfitojnë bursë studentët;

- që familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private,
- që vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi,
- që shpallen mbetës dhe humbasin vitin shkollor, për arsye të rezultateve jo kaluese.

Njoftimi është i publikuar në
adresën www.uniel.edu.al